



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash
Skupština Opštine Dragaš/DragasMunicipalit



PROCESVERBALI I HAPJES DHE VLERËSIMIT TË APLIKACIONEVE PËR THIRRJEN
PUBLIKE PËR PROPOZIME ME BASHKËFINANCIM

Data: 12/10/2022

Vendi: Dragash

Në bazë të vendimit të lëshuar nga Kryetari i Komunës me nr. protokoli 02 nr. 400/01-27857/22, i datës 06.10.2022, formohet komisioni për hapjen dhe vlerësimin e propozimeve të dorëzuara nga OJQ-të në kuadër të thirrjes publike për propozime me bashkëfinancim.

Komisioni përbëhet nga:

Burim Qafleshi – kryetar (zyrtar komunal)

Fitim Spahiu – anëtar (zyrtar komunal)

Sirhan Bajrami – anëtar (zyrtar komunal)

Musli Nafezi – anëtar (shoqëri civile)

Nuridin Halili – anëtar (OJQ 'Guri i Zi')

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš
03 Nr. Nr. 400/01-1564/22
13.10.2022
Dragash - Dragaš

Data dhe vendi i hapjes dhe vlerësimit: 12.10.2022, ora 11:00, Zyrja nënkryetarit, K.K Dragash.

Lista e OJQ-ve të cilat kanë aplikuar në kuadër të thirrjes publike për propozime me bashkëfinancim, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Komuna e Dragashit, më 19.09.2022, me numër të protokolit: 04 Nr.400/01-26312/22.

Nr.	Emri i Organizatës	Data	Ora
1	OJQ Human Care	29.09.2022	14:10
2			
3			
4			

Dokumentet e kërkuara sipas thirrjes:

Nr.	Dokumenti	Po/Jo
1	Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së	Po
2	Çertifikata e Numrit Fiskal për OJQ	Po
3	Vërtetimi Tatimor	Po

4	Licensa valide nga MSH për shërbime mjekësore dhe licenca për shërbime sociale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Po
---	---	----




Lista e projekt propozimeve të dorëzuara dhe buxheti

Nr.	Emri i Organizatës/Titulli i projekt propozimit	Buxheti i propozuar i projektit
1	OJQ Human Care/Shëndet, mirëqenie sociale, edukim dhe ambient të pastër për të gjithë	185,780.00 Euro
2		
3		
4		

Komisioni ka hapur dhe vlerësuar propozimin e vetëm të dorëzuar në kuadër të kësaj thirrjeje. OJQ Human Care ka dorëzuar propozimin me të gjitha dokumentet përkatëse të kërkuara sipas thirrjes publike. Gjithashtu ka dorëzuar edhe formën e buxhetit për stafin që do të angazhohet. Mirëpo mungon elaborimi i mënyrës së realizimit të shërbimeve të propozuara, metodologjia e informimit dhe arritjes së 5600 banorëve të Komunës së Dragashit të përmendur si target dhe plani i shtrirjes kohore për secilin aktivitet. Propozimi gjithashtu nuk e ka të përfshirë komponentën e ambientin përgjatë propozimit por vetëm në titull.

Komisioni rekomandon që OJQ-së aplikuese t'i kërkojen këto sqarime nga drejtoria bartëse e thirrjes publike, para vazhdimit të procedurave të nënshkrimit të kontratës.

Komisioni :

1. Burim Qafleshi 
2. Fitim Spahiu 
3. Sirhan Bajrami 
4. Musli Nafezi 
5. Nuridin Halili 